



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Tiranë, më 19.12.2022

**Lënda:** Parashtrimet përfundimtare të Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 19.12.2022, para trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për çështjen ankim kundër vendimit nr. 257/2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni.

**Drejtuar:** Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

**Baza ligjore:** Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Të nderuar anëtarë të trupit gjykues,

Në përfundim të këtij shqyrtimi gjyqësor, në referencë të nenit 302 dhe 303 të Kodit të Procedurës Civile, duke iu qëndruar të gjitha shkaqeve të ankimit dhe parashtrimeve me shkrim të depozituara në seancën e datës 13.12.2022, Komisioneri Publik, pasi vlerësoi provat e administruara në kuadër të këtij gjykimi, për secilin shkak ankimi, kundrejt prapësimeve të paraqitura, vlerëson si më poshtë:

**I. Për sa i përket kontrollit të kriterit të pasurisë.**

**1.** Në kuadër të shkaqeve të ankimit për kontrollin e kriterit të pasurisë, ndër të tjera, gjatë debatit gjyqësor parashtruam nevojën për riçeljen e hetimit, me qëllim vlerësimin dhe përcaktimin e situatës faktike të disa indicieve të pa shqyrtuara plotësisht nga hetimi administrativ i Komisionit. Këto indicie rezultuan nga korrespondenca e ndjekur nga Komisioni me OSSHE-në, të dhënat e dërguara nga Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave (DPPPP), si dhe mungesa e hetimit për kontrata të mundshme shërbimi pranë UKT-së, në lidhje me subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur me të.

1.1 Subjekti i rivlerësimit së bashku me prapësimet mbi këtë shkak ankimi, në seancën gjyqësore të datës 13.12.2022, paraqiti disa akte, për të cilat, Kolegji vendosi të pranojë ato që plotësojnë kërkesat ligjore për t’u administruar në cilësinë e provës.

1.2 Komisioneri Publik, në analizë të provave të paraqitura, përkatësisht korrespondenca e ndjekur nga subjekti i rivlerësimit me OSSHE-në dhe kontratat bankare ku rezulton si palë nënshkruese në cilësinë e përfaqësuesit të bankës, personi i lidhur, bashkëshorti i subjekti të rivlerësimit, çmon se plotësohen nevojat e hetimit për këtë shkak ankimi.

2. Në lidhje me pasurinë apartament me sip. 123.5 m<sup>2</sup> dhe garazh me sip. 26.9 m<sup>2</sup>, ndodhur në Tiranë, në vlerën totale të tyre prej 118.600 euro, subjekti i rivlerësimit, në prapësimet e tij të paraqitura në seancën e datës 13.12.2022, ndër të tjera, ka risjellë në vëmendje rezultatet e hetimit administrativ dhe vlerësimin përfundimtar të Komisionit, duke i qëndruar kështu të njëjtave shpjegime të dhëna prej tij në kuadër të procesit të rivlerësimit.

2.1 Komisioneri Publik, lidhur me këtë shkak ankimi, vlerëson se, edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor në Kolegj, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën dhe se prapësimet e paraqitura nuk gjejnë mbështetje në provat e administruara. Në këto kushte, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk mbulon me të ardhura të ligjshme shpenzimet dhe investimet e deklaruara për vitet 2008 – 2016, duke u gjendur në kushtet e deklarimit të pasaktë dhe të pa mjaftueshëm të pasurisë, referuar nenit D të Aneksit të Kushtetutës, nenit 33, pika 5, germa “b” dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

## **II. Për kriterin e aftësive profesionale.**

3. Për sa i përket shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e aftësive profesionale, ndër të tjera, subjekti i rivlerësimit në prapësimet e paraqitura i ka qëndruar të njëjtave shpjegime duke referuar vlerësimin e kryer nga Komisioni. Në vijim të këtyre qëndrimeve, në lidhje me çështjen e transferuar (çështja civile nr. \*\*\*, e vitit 2015) nga Komisioni pranë organit kompetent për inspektim, sipas nenit 59, pika 4, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në cilësinë e provës vendimin me nr. \*\*\*/\*\* prot., datë \*\*.9.2020, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili ka vendosur arkivimin e rastit të paraqitur nga Komisioni, pasi ka kaluar afati i parashkrimit 5 vjeçar, përcaktuar nga neni 117 i ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar.

3.1 Komisioneri Publik, vlerëson se vendimi i ILD-së nuk është relevant për gjykimin e këtij rasti, për më tepër, që organi përkatës ka vendosur arkivimin e çështjes për shkak të mospërmbushjes së kriteve formale të pranueshmërisë për t’u marrë në shqyrtim. Sikundër kemi mbajtur qëndrim edhe në raste të tjera të ngjashme, Komisioneri Publik, çmon se vlerësimi i kësaj çështje, së bashku me shkaqet e tjera të ankimit, duhet përfshirë në juridiksionin rivlerësues të Kolegjit të Posaçëm të Apelit, për qëllim të nenit 179/b të Kushtetutës dhe nenit 59 të ligjit nr. 84/2016.

3.2 Pa dashur të kalojmë në përsëritje, vlerësojmë se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë të kundërtën e shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e aftësive profesionale. Komisioneri Publik, mbështetur në standardet e përcaktuara në nenin 74, të ligjit nr. 96/2016, i ndryshuar, vlerëson se ka qenë përgjegjësia e subjektit të rivlerësimit që, për secilin rast të trajtuar, duhet të kishte marrë masa për të shmangur shkeljen e afateve të gjyqimit të çështjes, të arsyetonte vendimet e ndërmjetme, të kujdesej për aktet dhe efektivitetin e njoftimit të palëve,

arsyetimit në kohë të vendimeve dhe dorëzimit të dosjeve, verifikimit të plotësisë dhe korrekhtësisë së dosjeve gjyqësore, me qëllim menaxhimin sa më efektiv të procesit gjyqësor.

3.3 Mangësitë e vërejtura paraqiten të natyrës përsëritëse, dhe si të tilla, të vlerësuara së bashku me mangësitë e konstatuara në çështjen civile nr. \*\*\*, të vitit 2015, në vlerësim të përgjithshëm të tre kritereve, mund të çojnë në vlerësim të ndryshëm nga sa ka arritur Komisioni.

3.4 Mbështetur në sa më sipër, në referencë të nenit E, të aneksit të Kushtetutës, ligjit nr. 84/2016, ligjit nr. 96/2016, të ndryshuar, dhe jurisprudencës së Kolegjit, konstatojmë se mangësitë e vërejtura janë të tilla që nuk justifikojnë apo të krijojnë bindjen se subjekti i rivlerësimit duhet të konfirmohet në detyrë.

### **III. Kërkimi përfundimtar i ankimit**

4. Duke përfunduar për sa parashtruar, Komisioneri Publik, çmon se, në kushtet kur mangësitë e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë nuk janë të vetme, por ato shoqërohen edhe me defekte dhe mangësi domethënëse në kriterin e aftësive profesionale, në zbatim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, ato duhen vlerësuar në tërësi, si një nga alternativat e vlerësimit të kritereve të procesit të rivlerësimit të parashikuar nga ligji.

5. Bazuar në dispozitën e pikës 3 dhe 7, të nenit F, të aneksit të Kushtetutës, shkronjës “b”, të pikës 1, të nenit 66, të ligjit nr. 84/2016, kërkojmë nga ana e Kolegjit të Posaçëm të Apelit të vendosë:

- Ndryshimin e vendimit nr. 257, datë 12.6.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Miranda Andoni.

## **KOMISIONERI PUBLIK**

**Irena NINO**